



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	10.11.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Tetor

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.10.2025 deri me 31.10.2025

Lipjan 2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit tetor, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka vazhduar me zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të planifikuara për këtë periudhë, duke u fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës bujqësore, rritjen e mbështetjes për fermerët, përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarët.

Gjatë këtij muaji është përfunduar montimi i serave me sipërfaqe 50 m² për përfituesit nga lista pritëse, të cilët kishin aplikuar në fazat e mëparshme të programit komunal të mbështetjes për prodhimin bujqësor.

Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e kushteve të kultivimit, nxitjen e prodhimit vendor dhe rritjen e të ardhurave të fermerëve përfitues.

Në bashkëpunim me organizatën Qatar Charity, ka filluar gjithashtu montimi i serave për familjet me gjendje të rëndë socio-ekonomike, të cilat kanë qenë pjesë e aplikimeve të mëparshme. Ky projekt do të vazhdojë edhe në muajt në vijim, duke përfshirë më shumë përfitues dhe duke shtrirë mbështetjen në zona të tjera rurale të komunës.

Gjatë muajit tetor është realizuar shpërndarja e motokultivatorëve për përfituesit e përzgjedhur, në kuadër të një ceremonie të organizuar në bashkëpunim me Qatar Charity.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe përfaqësues nga shteti i Katarit, të cilët shprehën kënaqësinë për bashkëpunimin me Komunën e Lipjanit dhe interesimin për zhvillimin e projekteve të reja në sektorin e bujqësisë.

Ky projekt ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve mekanike të fermerëve dhe në lehtësimin e punëve bujqësore.

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të qasjes në zonat bujqësore, ka filluar zhavorrimi i rrugës në fshatin Hanrovc, një projekt që pritet të përfundojë brenda një kohe të shkurtër.

Ky investim do të lehtësojë qarkullimin e mjeteve bujqësore dhe transportin e produkteve, duke ndihmuar në zhvillimin ekonomik e kësaj zone.

Drejtoria ka zhvilluar takime dhe vizita në terren me disa organizata të huaja që veprojnë në Kosovë, me qëllim identifikimin e mundësive për projekte të reja në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Përmes këtyre bashkëpunimeve, synohet sigurimi i fondeve shtesë dhe rritja e kapaciteteve profesionale të fermerëve përmes trajnimeve dhe asistencës teknike.

Është duke u bërë shqyrtimi i kërkesave të fermerëve që kanë pësuar dëme nga shkaqe natyrore gjatë vitit 2025. Komisioni nga Drejtorati i bujqësisë është angazhuar në verifikimin në terren dhe përgatitjen e raporteve vlerësuese për secilin rast, në mënyrë që të mundësohet kompensimi ose mbështetja përkatëse për fermerët e prekur.

Në bashkëpunim me shërbimet komunale, është vazhduar me intervenimet për trajtimin dhe menaxhimin e qenve endacakë, sipas kërkesave të qytetarëve në lagje të ndryshme të Komunës së Lipjanit.

Këto veprime kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë publike dhe krijimin e një ambienti më të qetë për banorët.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, gjatë muajit tetor, ka treguar përkushtim në zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorit bujqësor.